



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

NJËSIA E PROKURIMIT

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime**

**“PËR MIRATIMIN DHE ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE TË KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“SHËRBBIMI I MIRËMBAJTJES SË PAJISJEVE TË FOTOKOPJIMIT, PRINTIMIT DHE SKANIMIT PËR VITIN 2023”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CVP):**

MIRËMBAJTJE DHE RIPARIM I MAKINERIVE NË ZYRA **50310000-1**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**7.499.999** (shatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH

Në zbatim të nenit 2, pika 2/c, nenit 21 pika 1., nenit 33, nenit 41, pika 1/ë, dhe pika 2., të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në Kreun VII, neni 11 dhe neni 78 pika 2., të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore ka hartuar procesverbalin për miratimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta për kualifikim me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e këtij prokurimi është: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”

**Objekti i Prokurimit është: “Shërbimi i Mirëmbajtjes së Pajisjeve të Fotokopjimit, Printimit dhe Skanimit për vitin 2023”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CVP): Kodi për Mirëmbajtje dhe Riparim i Makinerive në zyra 50310000-1

**Fondi limit i këtij prokurimi është në vlerën/masën: 7.499.999 (shatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, me fonde të vëna në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë për vitin 2023.**

**Afati i kryerjes së shërbimit do të jetë: 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të Kontratës.**

Afati kohor për dorëzimin e ofertave: Neni 49, pika 3 e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se: “*Afati për pranimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi është jo më pak se 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës*”.

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave është 10 ditë.**

**Kontrata:**

Në nenin 4, pika 20 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”

*“Kontrata publike për shërbime janë kontrata publike, që kanë objekt kryerjen e shërbimeve, të tjera nga ato që përfshihen në pikën 19 të këtij neni.”*

Sa më lartë, do të jetë Kontratë Shërbimi.

Nënkontraktimi: Nuk lejohet

Lejohen pagesa të drejtëpërdrejta të nënkontraktorit: JO

Gjuha e prokurimit: Shqip

Dokumentet standarde të tenderit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar

## FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

## **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**Argumentimi:** *Kriteret e mësipërme bazohen në nenet 76,82 dhe 84 të LLP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 26 dhe nenit 41 pika 5 e V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

*Këto kërkesa i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për t’u siguruar se operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrat përkatës profesional ose tregtar, për të vërtetuar personalitetin juridik, për të vërtetuar që subjekti nuk ka shkelje penale, ka statusin aktiv dhe ka likuiduar të gjitha detyrimet.*

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme bazohet në nenin 82 dhe 83 të LLP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenet 14/1, 14/2, 25, 26 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 9).

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LLP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 41, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare: 2020,2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 1/b dhe pika 3, e LPP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pasi është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të vendosi kërkesa të cilat garantojnë se operatorët ekonomik pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën si dhe në nenin 43 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti Kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon një kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”* Gjithashtu në përputhje me nenin 55, pika 4, paragrafi 1 dhe 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”*

Vendosja e këtij kriteri kaulifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

**2.2.2** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve për vitet financiare: 2020, 2021, 2022, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me Akt- Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenit 43, pika 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, janë kërkuar bilancet e 2 (dy) viteve të fundit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht është bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”. Këto kërkesa tregojnë ecurinë ekonomike dhe financiare të operatorit ekonomik dhe vërtetojnë se operatori ekonomik ka kapacitetin e duhur ekonomik dhe financiar për të realizuar deri në fund kontratën duke evituar mosrealizimin total apo mosrealizimin brenda afateve të kontratës. Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit i dokumentuar me bilance i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv paraqesin vërtetësi dhe besueshmëri në pozicionin financiar të operatorit ekonomik.

**2.2.3** Vërtetim të 30 ditëve të fundit të lëshuar nga Bashkia ose Drejtoritë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023, pranë të gjitha njërive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST-ve.

**Argumentimi:** Në lidhje me Vërtetimin për likuidimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, kërkesa e mësipërme është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i dryshuar dhe në përputhje me nenin 76, pika 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023, sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht me Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari tregtare, kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur sipas përcaktimeve bazuar në nenin 77, pika 4., të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe të nenit 40, pika 4 dhe nenit 55, pika 4/b., të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, pasi është në të drjtën e Autoritetit Kontraktor të vendosi kërkesat të cilat garantojnë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për ta zbatuar kontratën.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor janë kërkuar vërtetimin për realizimin e kontratave të ngjashme në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur për të vërtetuar që ofertuesi/ofertuesit pjesëmarrës ka/kanë përvojën e duhur, ka/kanë kapacitetet e duhuara si teknike dhe organizative për të realizuar një kontratë të tillë. Paraqitja e vërtetimit për realizimin me sukses të kontratave të ngjashme nga ana e Operatorit Ekonomik dëshmon me korrëktësi në përmbushjen me sukses të detyrimeve kontraktore të Operatorit Ekonomik në raste të tjera të ngjashme si në cilësi ashtu dhe në afatet duke krijuar besueshmëri te Autoriteti Kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës.

Në bazë të këtij kriteri operatorët ekonomik vërtetojnë eksperiencën në fushën objekt prokurimi dhe autoriteti kontraktor merr garancinë e nevojshme që shërbimi do të kryhet me sukses. Përvoja e operatorit ekonomik është një element shumë i nevojshëm për autoritetin kontraktor për të vërtetuar qëndrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmëria në përmbushjen e suksesshme të kontratës. Për kontratat e realizuara nga operatori ekonomik, operatori duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar me qëllim të shërbej autoritetit në vlerësimin sa më të qartë të kriterit për eksperiencat e ngjashme.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë autorizimi nga prodhuesi dhe/ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit për shitje dhe shërbim (mirëmbajtje/riparim) për procedurën e cila duhet të përmbajë dhe kontaktet e prodhuesit. Distributori lokal që lëshon autorizimin, duhet të paraqesë kontratën të noterizuar që ka me prodhuesin, ku të shprehen qartë të drejtat e tij për dhënie autorizimi tek të tretët.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 1, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se:

*Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) Përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) Gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) Aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitete juridike, financiare dhe aftësi teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë propocionale me objektin e kontratës. Neni 40, pika 3 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Sa më lartë dhe në përputhje të plotë me dispozitat ligjore Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e kriterit 2.3.2.

Gjithashtu në nenin 41 pika 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet se:

*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*



Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të fotokopjimi, printimit dhe skanimit për vitin 2023, përfshin:

1. *Shërbim Mirëmbajtjes pajisje RICOH, Tipi: MP 2000, MP 3350, MP 171, MP 3554, MP 2701, MPC 3002, MPC 4502, MPC 305, MPC 306.*

*Printim-Skanim-Fotokopjim: Format A4*

2. *Shërbim Mirëmbajtje pajisje XEROX, Tipi: Nr. 5222, Nr. 5225, Nr. 5665, Nr. 5645, Nr. B7030.*

*Printim-Skanim-Fotokopjim: Format A4*

Duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimit, Njësia e Prokurimit gjykon të nevojshme dhe të domosdoshme se operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë autorizimi nga prodhuesi dhe/ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit për shitje dhe shërbim (mirëmbajtje/ riparim) me anë të së cilës dëshmojë se është i autorizuar prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga ky i fundit për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve objekt prokurimi të cilat janë në pronësi nga ana e Autoritetit Kontraktor. Për këtë qëllim, duke marrë në konsideratë testin balancues të propocionalitetit, Njësia e Prokurimit gjykon se kërkesa shtrihet vetëm mbi grup pajisjet të cilat përbëjnë edhe numrin më të madh të pajisjeve në pronësi.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e certifikatës së autorizimit nga prodhuesi dhe/ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit për kryerjen e shërbimit është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti Kontraktor, duke qënë se është përfitues direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes, (konkretisht në seksionin “Objekti” të Specifikimeve Teknike parashikohet se: *“Shërbimi i printimit/fotokopjimit konsiston në ofrimin e të gjitha pjesëve konsumuese të fotokopjes (zhvillues, cilindër, gomina etj) dhe të mirëmbajtjes nga ana teknike të pajisjes. Operatori ekonomik paguhet në bazë të faqeve të printuara/fotokopjuara nga pjsisjet”, si dhe për furnizimin me tonëra sipas nevojës.* Për rrjedhojë mund t’iu kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar, Njësia e Prokurimit vlerëson se Autoriteti Kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Akoma më tej, Nj. Prokurimit gjykon se dokumenti i kërkuar mund të sigurohet lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre furnizimin me mallra për të cilat kanë për detyrë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e tyre. Me kriterin e vendosur Autoriteti Kontraktor nuk ka tejkualuar objektin e prokurimit pasi për autoritetin është e rëndësishme të sigurohet që shërbimi i mirëmbajtjes të kryhet vetëm nga operatorë të cilët diponojnë mardhënie partneriteti me

prodhuesin/distributorin e autorizuar. Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve të printimit luan një rol kyç për mbarëvajtjen e punës të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV), për këtë arsye dhe në termat e referencës është kërkuar ndër të tjera se: *“Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve RICOH dhe XEROX do të përfshijë: mirëmbajtjen 24 orë të pajisjeve në gjëndje pune, furnizimin me tonerë, kryerjen e defekteve të ndryshëm në çdo kohë, zëvendësimin e pajisjeve të konsumit (cilindra, zhvillues, gomina etj.), sipas përcaktimeve që vijnë më poshtë.”*

Për këtë arsye kërkesa për disponueshmërinë e një stafi teknik të certifikuar për kryerjen e shërbimit të riparimit brenda periudhës së kërkuar është në propocion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar minimalisht 6 (gjashtë) persona, nga këta 4 (katër) persona duhet të jenë Staf Teknik me diploma inxhinieri (IT, inxhinier elektronik, apo të fushës së IT-së).

- Stafi teknik duhet të jetë i certifikuar për përmbajtjen e pajisjeve për markat e pajisjeve RICOH dhe XEROX, konkretisht (1 (një) specialist të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve Ricoh A3/A4 dhe 1 (një) specialist të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve Xerox A3/A4).
- Certifikata e trajnimit për stafin teknik duhet të jetë e lëshuar nga prodhuesi i markës RICOH dhe XEROX ose ekuivalente *(në rastin e certifikatave ekuivalente këto duhet të jenë të lëshuara nga akademi/distributor të autorizuar të cilat janë të njohura nga prodhuesi i pajisjes, me kusht që të provohet e drejta legjitime për të trajnuar dhe certifikuar stafin për mirëmbajtjen e pajisjeve objekt kontrate).*
- Në rastin kur certifikata e trajnimit është lëshuar nga prodhuesi, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontaktet (emër, mbiemër, nr. kontakti, adresë postare, adresë e-mail) të kompanisë prodhuese për vërtetimin e autenticitetit të certifikatave nga ana e Autoritetit Kontraktor.
- Në rastin e certifikatave ekuivalente kur janë të lëshuara nga akademi/distributor të autorizuar të cilat janë të njohura nga prodhuesi i pajisjes, me kusht që të provohet e drejta legjitime për të trajnuar dhe certifikuar stafin për mirëmbajtjen e pajisjeve RICOH dhe XEROX, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontaktet e institucionit (emër, mbiemër, nr. Kontakti, adresë postare, adresë e-mail) për vërtetimin e autenticitetit të certifikatave nga ana e Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është në përputhje me parashikimet e neni 41, pika 4 dhe pika 6 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet komponente shtetërore; dhe/ose* b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës.*

*“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

*Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

Kriteri i mësipërm në lidhje me disponueshmërinë e stafit teknik të kualifikuar, Njësia e Prokurimit vlerëson se duke marrë në konsideratë natyrën dhe kohëzgjatjen e shërbimit, edhe volumi i lartë i printimit për të cilat do të ofrohet shërbimi, shfaqet e nevojshme të paktën 4 (katër) ekspertë me nivel kualifikimi inxhinier të profileve të ndryshme të cilat do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes. Numri 4 (katër) është një numër propocional për kryerjen e shërbimit.

Gjithashtu, 4 (katër) prej ekspertëve të mësipërm krahas nivelit të kualifikimit inxhinier IT, inxhinier elektronik ( e lënë e hapur duke mos shfaqur diskriminim të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë).

Stafi teknik duhet të disponojë edhe dëshmi kualifikimi certifikimi për mirëmbajtjen e pajisjeve për markat e pajisjeve: të paktën 1 (një) persona staf teknik për pajisjet RICOH A4/A3 ose **ekuivalente**: dhe një (1) persona staf teknik për pajisjet XEROX A3/A4 ose **ekuivalente**.

Duke qënë se ekspertët mund të disponojnë dëshmi kualifikimi ekuivalente të lëshuara nga akademi/distributor të autorizuar të cilat janë të njohura nga prodhuesi i pajisjes, me kusht që të provohet e drejta legjitime për të trajnuar dhe certifikuar stafin për mirëmbajtjen e pajisjeve objekt kontrate.

**2.3.4** Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akredituese të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht: Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë certifikata të vlefshme:

a) Certifikatë **ISO 9001: 2015 Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë** ose ekuivalente e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen.

b) Certifikatë **ISO 27001: 2013 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Informatike** ose ekuivalente e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen.

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikën 1, të nenit 79, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

*“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit si dhe referuar nenit 44 pika 1., të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.” Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilësisë”.*

Përmbushja e standardeve ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

ISO 9001:2015 “Çertifikatë e Menaxhimit të Cilësisë”, përcaktohet si standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, në mënyrë që Operatori Ekonomik të ketë një sistem më të mirë menaxhimi, planifikim më të mirë të aktivitetit, zgjidhje me të shpejtë të problemeve, rritje të produktivitetit, fitimeve dhe reputacionit si dhe ndërmarrja e veprimeve të duhura për të përmirësuar vazhdimisht të gjitha aktivitetet e kryera nga operatorët ekonomik.

Sa më sipër ky kriter është vendosur pasi për nga natyra dhe përmasat e objekt të kontratës që do të prokurohet është tepër e rëndësishme që operatori ekonomik si zbatues i shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve të printimit, fotokopjimit dhe skanimit të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë.

ISO 27001:2013 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Informatike është e rëndësishme pasi siguron zbatimin e sigurisë së informacionit të shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Për një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit që mund të zbatohet dhe certifikohet në çdo shoqëri, pavarësisht nga madhësia e saj dhe pavarësisht nga kategoria e informacionit të përpënuar. Ky standard përqëndrohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të sigurisë dhe zbatimin e kontroleve të përshtatshme për të mbrojtur informacionin, pavarësisht suportit të tij (psh. letër elektronike).

Për natyrën dhe përmasat e objektit të kontratës që do prokurohet është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues të shërbimit të zhvillimit dhe mirëmbajtjes të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i cilësisë, sigurisë së informacionit dhe shërbimit të teknologjisë së informacionit, janë standard që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës dhe nuk përbëjnë kritere dikriminuese përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim janë kërkuar që t'i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotrojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

### **Specifikimeve Teknike për Shërbimin e Mirëmbajtjes së Pajisjeve të Fotokopjimit, Printimit dhe Skanimit për vitin 2023.**

1. Shërbim Mirëmbajtje pajisje **RICOH**, Tipi: MP 2000 (2 copë), MP 3350 (2 copë), MP171 (2 copë), MP3554 (4 copë), MP 2701 (2 copë) , MPC 3002 (1 copë), MPC 4502 (2 copë), MPC 305 (3 copë), MPC 306 (4 copë).  
Printim-Skanim-Fotokopjim: Format A4  
(Pajisje **RICOH** në total 22 copë)
2. Shërbim Mirëmbajtje pajisje **XEROX**, Tipi: Nr. 5222 (1 copë), Nr. 5225 (1 copë), Nr. 5665 (1 copë), Nr. 5645 (1 copë), Nr. B7030 (2copë).  
Printim-Skanim-Fotokopjim: Format A4  
(Pajisje **XEROX** në total 6 copë)

### **Qëllimi:**

Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, kërkon të realizoj shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve (fotokopje/printer) RICOH dhe XEROX. Me realizimin e këtij shërbimi synohet sigurimi i kushteve normale të punës për punonjësit, nëpërmjet një shërbimi cilësor e të vazhdueshëm, duke eliminuar problematikat e shumta të gatishmërisë së tyre për shkak

të defekteve të ndryshme dhe mungesës apo cilësisë së ulët të bojërave (tonerëve) që qarkullojnë në treg.

### **Objekti:**

Objekti i kësaj procedure konsiston në realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së fotokopjeve RICOH dhe XEROX do të mundësojë kryerjen e printimit / fotokopjimit / skanimin të dokumenteve të ndryshme shkresore të administratës, sipas përcaktimeve që janë bërë në hartimin e termave të referencës.

Shërbimi i mirëmbajtjes konsiston në ofrimin e të gjitha pjesëve konsumuese të fotokopjes (zhvillues, cilindër, gomina etj) dhe të mirëmbajtjes nga ana teknike të pajisjes. Operatori ekonomik paguhet në bazë të faqeve të printuara/fotokopjuara nga pajisjet.

Fotokopjet janë të lidhura në rrjet dhe përdoren nga të gjithë punonjësit e drejtorisë. Për shkak të volumit të punës pajisjet duhet të funksionojnë 24 orë pa asnjë ndërprerje dhe do të jenë të kompletuara me tonerë dhe pjesët konsumuese të tyre.

### **Detyrat:**

Operatori ekonomik i shpallur fitues, brenda vlerës së ofertuar, duhet të siguroj me mundësitë dhe shpenzimet e veta ofrimin e të gjitha pjesëve konsumuese të fotokopjes (zhvillues, cilindër, gomina etj.) dhe të mirëmbajtjes nga ana teknike të pajisjes. Operatori ekonomik paguhet në bazë të faqeve të printuara/fotokopjuara nga pajisjet.

Fotokopjet janë të lidhura në rrjet dhe përdoren nga të gjithë punonjësit e Autoritetit Kontraktor. Për shkak të volumit të punës pajisjet do të funksionojnë 24 orë pa ndërprerje dhe do të jenë të kompletuar me tonerë dhe pjesët e tjera të konsumueshme.

Shërbimi i mirëmbajtjes së paisjeve RICOH dhe XEROX do të përfshijë: mirëmbajtjen 24 orë të pajisjeve në gjendje pune, furnizimin me tonerë, kryerjen e defekteve të ndryshëm në çdo kohë, zëvendësimin e pjesëve të konsumit (cilindra, zhvillues, gomina etj.) sipas përcaktimeve që vijnë më poshtë.

### **Specifikimet teknike:**

Specifikimet teknike për pajisjet (fotokopjet/printer) e kërkuara mësipër, janë si më poshtë vijon:

- Shërbim të fotokopjeve në nivelin 100% gjatë gjithë periudhës së shërbimit – kjo përfshin çdo orë e ditë pune.

1. Shërbimi do të përfshij pastrimin/ shërbimin periodik të të gjithë komponenteve të vegjël e të mëdhenj dhe kurdoherë është e nevojshme zëvendësimi i pjesëve të konsumit apo pjesëve të këmbimit.
2. Zhvilluesit / tonerët dhe pjesët e tjera të konsumueshme sigurohen nga kontraktori pa asnjë kosto shtesë (kosto do të jetë e përfshirë në çmimin për kopje).

Fotokopjet/Printer (pajisjet) do të mirëmbahen me të gjitha mënyrat dhe mjetet parandaluese të mosfeksionimit të tyre, dhe për të parandaluar në kohë çdo lloj defekti i cili i bën të paoperueshme këto fotokopje (p.sh. mbarimi i tonerëve, cikli i jetës së fuserit (FK), cilindrit (MK), DP etj. të matshme në mënyrë elektronike nga vetë pajisja). Mirëmbajtja do të parashikojë punën e kujdesshme të kontraktorit për të riparuar saktë e pa gabime pajisjen dhe duke mos krijuar asnjë shkak të drejtpërdrejtë ose jo, për krijimin e qarqeve të shkurtra elektrike në pajisje të cilat mund të shkaktojnë djegie ose zjarr.

Shërbimi dhe riparimi i fotokopjeve do të bëhet me pjesë origjinale të prodhuesit. Shërbimi do të jetë minimalisht mujor dhe i pranuar nga përdoruesi. Kontraktori duhet të sigurojë një pikë kontakti me AK dhe të ketë një "Helpdesk" për të trajtuar të gjitha shqetësimet apo kërkesat për shërbim nga AK.

Koha e përgjigjes nga operatori do të jetë: Jo më vonë se ditën pasardhëse të punës, pas njoftimit për asistencë.

*Në rastin e ndërprerjes së punës në fotokopje (pajisje) për më shumë se 24 orë dhe kur defekti i konstatuar rezulton të jetë shumë i rëndë duke ndërprerë procesin e punës për më shumë se 48 orë në ditët vijuese, atëherë operatori ekonomik është i detyruar të pajis me një fotokopje back-up (rezervë) për të kryer procesin normal të punës nga përdoruesi.*

Gjithashtu stafi teknik që do të kryej shërbimet duhet të jetë i trajnuar nga prodhuesit dhe të ketë një përvojë pune në fushën e mirëmbajtjeve të pajisjeve fotokopjuese, offseteve, etj.

Operatori ekonomik në përfundim të kontratës duhet të garantojë AK se pajisjet do të jenë në gjendje pune dhe pjesët e konsumit duhet të jenë të pakonsumuara në një shkallë prej jo më pak se 80 % të tyre.

Autoriteti Kontraktor për realizimin e nevojave të tij, kërkon nga ana e operatorit ekonomik, të vendosë në përdorim të Autoritetit Kontraktor, 25 pajisje të tjera shtesë (përveç atyre ekzistuese/të përcaktuara mësipër) për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës, sipas karakteristikave të mëposhtme:

**2 pajisje - A4/3 me shpejtesi të mesme me këto specifikime :**

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia jo me e vogel se:	30 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	25.5 cm (10.1 inch)
Resolucioni i printimit:	600x600 dpi
Dimensioni W x D x H (mm) , jo me i madh se:	350x495x505
Kapacitetimbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	300 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	100 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja jo me e vogel se:	2 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Lidhja/Connection	Ethernet, USB
Mundesit skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoj skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: ARDF	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, USB, SD Card)
Shpejtesia e Skanimit	30 ipm
Mobile printing (aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoj encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoj skanimin e dokumentave direct ne Cloud.	



**10 pajisje - A4 me shpejtësi të mesme me këto specifikime:**

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia jo me e vogel se:	30 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	25.5 cm (10.1 inch)
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H (mm), jo me i madh se:	480x445x510
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	500 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	250 faqe
Madhesia e letres	A6-A4
Memorja jo me i Vogel:	2 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesit skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoj skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershëm te dy aneve te letres)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)
Shpejtesia e skanimit	40 ipm (simplex) / 80 ipm(duplex)
Mobile printing (aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoj encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.

Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Cloud.	

**13 pajisje me ngjyra - A4 me këto specifikime:**

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/me ngjyra
Shpejtesia jo me e vogel se:	30 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	25.5 cm (10.1 inch)
Resolucioni i printimit:	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H (mm), jo me imadh se:	500x565x510
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	200faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	150faqe
Madhesia e letres	A6-A4
Memorja jo me e vogel se:	2 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Lidhja/Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)
Shpejtesia e skanimit	40 ipm (simplex) / 80 ipm (duplex)
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria

Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Cloud.	

**Argumentimi:** *Specifikimet teknike përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 41, pika 1 dhe nenit 44 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

*Këto specifikime teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor për shërbimin objekt prokurim, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura, sipas parashikimeve ligjore të mësipërme. Njësia e Prokurimit, gjykon se specifikimet teknike të vendosura janë të nevojshme për të garantuar ofrimin e një shërbimi cilësor, por edhe për të orientuar operatorët ekonomikë në lidhje me shërbimet/materialet/punën për të cilën ata duhet të paraqesin ofertën e tyre.*

### **Shërbimet që kërkohen:**

#### **Afatet e ekzekutimit:**

Operatori Ekonomik do të paguhet për sasi të kryera të shërbimit për kopje A4 printim dhe fotokopjimi.

Sasia e printimit/fotokopjimit/skanimit bardh e zi – A4 për XEROX;  A4 për RICOH	3.349.514 kopje A4
Sasia e printimit/fotokopjimit/skanimit me ngjyra – A4 për XEROX;  A4 për RICOH	40.000 kopje A4

*\*Shënim: Printimi, fotokopjimi dhe skanimi për A3 do të llogariten sa 2 x A4.*

**TOTALI: 3.349.514 fletë A4 bardhë e zi + 40.000 fletë A4 me ngjyra**

**Afatet e ekzekutimit:**

**AFATET E EKZEKUTIMIT: Nga momenti i lidhjes së kontratës, për 12 (dymbëdhjetë) muaj.**

**Vendi i Ekzekutimit:** Në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, me adresë: Rruga e Kavajës, Ndërtesa 205, 1023 pranë kompleksit rezidencial “Square 21”, 1023, Tiranë - Shqipëri.